Sarandë/ Sherri masiv në fshatin Gjashtë, AMP arreston 8 persona, mes tyre 4 policë! Sekuestrohen 3 pistoleta (EMRAT)

Lidhur me sherrin masiv mesnatën e mbrëmshme në fshatin Gjashtë të Sarandës, ku u përfshinë dhe disa punonjës policie jashtë shërbimit, janë arrestuar 8 persona prej Agjencisë së Mbikqyrjes Policore.

■ Sarandë/ Sherr masiv mes 12 personave në fshatin Gjashtë! Të përfshirë dhe 4 policë, 3 prej tyre vëllezër! Efektivët ishin jashtë shërbimit (EMRAT+FOTO)

■ Dëshmia për Report Tv: 10 vetë me në krye policin shkuan pas mesnate te vëllezërit që japin makina me qira dhe i dhunuan me sende të forta

Fotografi Sulejmani/ Shqiptarja.com/ Arsenal AMP

Redaksia
2 Janar, 19:19 | **Përditësimi: 2 Janar, 20:18**

Share

A A

SARANDË - Lidhur me sherrin masiv mesnatën e mbrëmshme në fshatin Gjashtë të Sarandës, ku u përfshinë dhe disa punonjës policie jashtë shërbimit, janë arrestuar 8 persona prej Agjencisë së Mbikqyrjes Policore.

Rreth orës 01:30, të datës 2 janar 2025, në fshatin Gjashtë, pranë një restoranti, ndodhi një konflikt fizik mes disa shtetasve, ku u përdorën sende të forta dhe armë zjarri. Dy persona, Enea Nexhipi dhe Albion Nexhipi (vëllezër), u dëmtuan lehtë dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën.Gjatë ngjarjes, punonjësi i policisë Alvaro Sulejmani përdori armën e shërbimit.

Sipas déshmive për Report Tv, dy vëllezërit e dëmtuar drejtonin një biznes të makinave me qira. Alvaro Slejmani i kishte një borxh atyre, lidhur me një makinë që u kishte marrë. Ai u shkoi te shtëpia e vëllezërve Nexhipi pas mesnatë së bashku me 10 vetë të tjerë dhe sic dëshmohet, i ka dhunuar duke gjuajtur me sende të forta dhe me armë, duke i lënë të lënduar dy vëllezërit që janë jashtë rrezikut për jetën.

LEXO EDHE:
Sarandë/ Kërcënoi qytetarin me armë zjarri, pezullohet punonjësi i policisë në Ksamil (EMRI+VIDEO)

AMP arrestoi 4 punonjës policie, Alvaro, Inklid dhe Mihal Suljmani (vëllezër) si dhe Ergis Sulejmani kushëri i tyre, dhe 4 shtetas, ndërsa 2 po hetohen në gjendje të lirë dhe 2 të tjerë u shpallen në kërkim.

Të arrestuar:
Punonjës policie:
Alvaro Sulejmani,
Inklid Sulejmani,
Mihal Sulejamni,
Ergis Sulejmani
Shtetas:
Kejsi Sulejmani,
Shemsho Sulejmani,
Delars Duka,
Kristjan Xhaferi.

Të ndjekur në gjendje të lirë:
Enea Nexhipi,
Albion Nexhipi

Të shpallur në kërkim:
Igli Duka,
Beqir Çoçka

Provat e sekuestruara:
3 pistoleta,
4 automjete
7 celularë.

Hetimet po vazhdojnë për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Njoftimi i AMP-së:

AMP arrestoi 4 punonjës policie dhe 4 shtetas, 2 shtetas referohen në gjendje të lirë dhe 2 shtetas shpallen në kërkim

Më datë 02.01.2025, rreth orës 01:30, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Sarandë, nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, ka bërë të mundur parandalimin e një ngjarje të rëndë, pasi në fshatin Gjashtë të Sarandës, përballë një biznesi restorant, janë konfliktuar me sende të forta disa shtetas, ku nga verifikimet dhe veprimet e kryera, jane identifikuar shtetasit E. N. dhe A. N., të cilët janë dëmtuar me sende të forta dhe janë jashtë rrezikut për jetën.
Punonjësi i policisë A.S gjatë konflikëit ka përdorur dhe ka qëlluar me armën e shërbimit.

Gjithashtu, të përfshirë kanë gëzë edhe shtetasit I. N. dhe O. B., të cilët janë konfliktuar me punonjësit e policisë I. S., A. S., M. S. dhe E. S., si dhe shtetasit Sh. S., B. Ç., K. Xh., I. D., D. D. dhe K. S.

Nga veprimet hetimore të kryera nga AMP (kikqyrja në vendin e ngjarjes, kikqyrja e kamerave dhe deklarimet e marra) ka arrestuar në flagrancë për veprat penale "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë", "Shkatërrim i pronës", "Plagosje e lehtë me dashje", "Kanosja", "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik".
Punonjësit e policisë:
1. A.S, me detyrë SPZ në Komisariatin e Policisë Himarë (I dyshuar për veprën penale "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë")
2. I.S., me detyrë agjent në seksionin e hetimit në Komisariatin e Policisë Sarandë
3. M.S., student në Akademinë e Sigurisë
4. E.S., me detyrë inspektor në Komisariatin e Policisë Sarandë
Shtetasit:
1. K. S.
2. Sh. S.
3. D. D.
4. K. S.

U ndoqën në gjendje të lirë për veprat penale "Shkatërrim i pronës" dhe "Plagosje e lehtë me dashje", shtetasit E. N. dhe A. N.

Janë shpallur në kërkim për veprat penale "Shkatërrim i pronës", "Plagosje e lehtë me dashje", "Kanosja", "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", shtetasit I. D. dhe B. Ç.

Në cilësinë e provave materiale janë sekuestruar 3 pistoleta, 4 automjete dhe 7 aparate celulare.

G.K/Shqiptarja.com

TAG: Video sarandë gjashtë Alvaro Sulejmani Inklid Sulejmani Mihal Sulejmani Ergis Sulejmani Kejsi Sulejmani Shemsho Sulejmani Delars Duka Kristjan Xhaferi Enea Nexhipi Albion Nexhipi Igli duka Beqir Çoçka

Komente

Real: 03/01/2025 00:33
Mos u çudisni fare se kjo eshte fytyra e policise se shtetit. Imaginoni te kerkoni ndihme prej keteve. 3 vellezer police duhet te akuzohem si grup i strukturuar kriminal sebaskiu me ata qe i mbeshteten.

Ndalohet ripërdorimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Çfarë prisni në vitin 2025?

Punë Shëndet Mirëqenia

Lajme të tjera

Vlorë/ Arrestohet hajduti i marketeve, 7 bastisje në 3 javë! Shqyente dyert me leva, e kapën kamerat e sigurisë (EMRI+VIDEO)
Armand Xhelili
2 Janar, 12:54

Sarandë/ Sherr masiv mes 12 personave në fshatin Gjashtë! Të përfshirë dhe 4 policë, 3 prej tyre vëllezër! Efektivët ishin jashtë shërbimit (EMRAT+FOTO)
Limos Didani
2 Janar, 09:14

VIDEOLAJM/ Plazh në janar, qytetarët sfidojnë të fohtin në Vlorë
2 Janar, 08:14

Festuan Vitin e Ri/ Mbi 125 persona në urgencën e Lezhës e Vlorë, shkak konsumimi i alkoolit dhe dëmtimi nga fshekzjarret
Armand Xhelili
Elvis Hila
1 Janar, 14:19

Liberalizimi, nga sot 2600 biznese në tregun e lirë të energjisë
1 Janar, 11:48

Spektakël fishekzjarresh në Sarandë, qytetë bregdetar shkëlqen nga ngjyrat dhe dritat
1 Janar, 01:11

Mirësevjen 2025! Në Tiranë, spektakël fishekzjarresh e koncert në shesh! Atmosferë festive në çdo qytet! Shqiptarët kudo urojnë: Gëzuar!
31 Dhjetor 2024, 10:58

Gjykatat sekuestruan bazën detare të Limionit, Rama: Skandal i paperceptueshëm! Nëse aty cenohet siguria, të ikim të gjithë nga vendi! Po bllokohen 300 mln euro
30 Dhjetor 2024, 14:25

Vlorë/ Gruaja i vendos flakën gomave të makinës pranë ish-fabrikës së Sodës, tymi i zi mbulon zonën
29 Dhjetor 2024, 13:42

Kur fjala 'strehë' humb kuptimin! Mjerim në familjen Abazaj në Selenicë, 3 fëmijët mes lotëve: Duam shtëpi të re
Armand Xhelili
29 Dhjetor 2024, 13:16

Digjet prej 4 ditësh fusha e mbetjeve në Vlorë, tymi mbulon zonën
29 Dhjetor 2024, 11:28

Në prag të Vitit të Ri, rritet fluksi i pasagjerëve në Portin e Vlorës! Brataj: 6 orë në radhë për të zbritur nga trageti
Armand Xhelili
29 Dhjetor 2024, 11:21

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje